

Tregtimi dhe Trafikimi i Paligjshëm i Armëve dhe Municioneve: Nevojat për Përmirësime në Legjislacionin Penal

Ardit Mustafaj*

Abstrakt

Politika penale kundër veprimtarive të paligjshme të tregtimit dhe trafikimit të armëve dhe municioneve luftarake dhe nevoja për përshtatjen e legjislacionit shqiptar me aktet përkatëse ndërkombëtare ka kërkuar ndryshime dhe përmirësime të shpeshta në legjislacionin tonë penal. Qëllimi i punimit është që të evidentojë disa probleme të ndeshura në zbatimin e dispozitave penale lidhur me veprimtarinë e paligjshme të tregtimit të armëve dhe municionit luftarak për rastet kur ajo kryhet brenda vendit, si një hallkë që shpesh ndodhet mes trafikimit të paligjshëm nga/për jashtë shtetit dhe mbajtjes apo përdorimit të tyre për kryerjen e krimeve të tjera (referencë janë nenet 278 dhe 278/a të Kodit Penal). Punimi analizon se si praktika gjyqësore ka evidentuar se ndryshimet e legjislacionit penal e kanë lënë të pambuluar siç duhet këtë veprimtari.

Punimi arrin në përfundimin se kërkohen përmirësime të mëtejshme të Kodit Penal për t'iu përgjigjur përhapjes si një veprimtari më vete të tregtimit (shitblerjes) të paligjshëm të armëve dhe municioneve brenda vendit, duke propozuar edhe një strukturim të ndryshëm të dispozitave penale konkrete mbi bazën e parimit të prekjes dhe përdorimit të territorit, duke marrë për model ato të narkotikëve në këtë kod.

Fjalë kyç: politikë penale, tregtim i paligjshëm, armë

1 Hyrje

Nevoja për të forcuar politikën penale kundër tregtimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve dhe municioneve dhe për të përshtatur legjislacionin tonë me aktet përkatëse ndërkombëtare ka diktuar ndryshime të herëpashershme të legjislacionit tonë penal. Në mënyrë të posaçme ndryshimet kanë qenë të orientuara në luftimin e kriminalitetit të organizuar dhe veprimtarive kriminale që lidhen më të, siç janë trafikimet e ndryshme, terrorizmi, pastrimi i produkteve të krimit dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

* Gjyqtar, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Përmirësimet e legjislacionit penal kanë rritur shkallën e përgjigjes së shtetit dhe shoqërisë ndaj këtij kriminaliteti, por praktika e gjykatave tona ka zbuluar mangësi në mbulimin e plotë nga ligji penal të disa shfaqjeve të veçanta të veprimtarive kriminale që lidhen me armët dhe municionet.

Në këtë punim evidentohen disa probleme të ndeshura në zbatimin e dispozitave penale lidhur me veprimtarinë e tregtimit të paligjshëm të armëve të zjarrit dhe municionit luftarak për rastet kur ajo kryhet brenda vendit. Ai analizon se si praktika gjyqësore ka evidentuar se nga ndryshimet e herëpashershme të legjislacionit penal ka mbetur e pambuluar siç duhet kjo veprimtari dhe për pasojë adresimi i saj në kuadër të politikës penale ka vend që të jetë më i mirë, duke dhënë në përfundim edhe propozime konkrete për të rregulluar mangësitë e vërejtura.

2 Legjislacioni aktual

Legjislacioni shqiptar në fushën e kontrollit të veprimtarive të paligjshme që lidhen me armët dhe municionet ka pësuar ndryshime të shpeshta të cilat kanë patur për qëllim përmirësimin tij, në përmbushje të dy orientimeve të përgjithshme që janë në funksion të njëra-tjetrës: së pari, për të forcuar politikën e luftimit të këtij lloji kriminaliteti dhe, së dyti, për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me aktet juridike ndërkombëtare të fushës të ratifikuara nga vendi ynë. Aktualisht mekanizmat kryesorë ligjorë në vendin tonë që rregullojnë veprimtaritë në lidhje me importimin, eksportimin, tranzitimin, tregtimin, qarkullimin, mbajtjen e armëve ose pjesëve të tyre dhe municioneve, janë si më poshtë:

Ligji nr. 9838, datë 10.12.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”. Me anë të tij ligji vendi ynë aderoi dhe bëri pjesë të legjislacionit të brendshëm Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, i cili plotëson në këtë fushë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, duke u konsideruar pjesë e kësaj konvente.¹ Hartimi i këtij Protokolli erdhi për shkak se shtetet palë ishin të vetëdijshme mbi nevojën urgjente për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, për shkak të efekteve të dëmshme të aktiviteteve në fjalë ndaj sigurisë së çdo shteti, rajoni dhe shoqërisë në tërësi, duke rrezikuar mirëqenien e njerëzve, zhvillimin e tyre social dhe ekonomik dhe të drejtën e tyre për të jetuar në paqe dhe për faktin se ato ishin të bindura, për pasojë, mbi domosdoshmërinë e të gjitha shteteve për të

¹ Neni 1 i Protokollit.

ndërmarrë të gjitha masat e duhura për arritjen e këtij qëllimi, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe masa të tjera në nivele rajonale dhe globale.² Qëllimi i këtij instrumenti ndërkombëtar është që të nxisë, lehtësojë dhe forcojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, me qëllim parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve.³ Nxitja e bashkëpunimit mes shteteve është qëllimi madhor i vetë Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar,⁴ në plotësim të të cilit është hartuar edhe Protokollin në fjalë.

Ky Protokoll zbatohet për parandalimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, për investigimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të shkaktuara sipas nenit 5 të këtij protokollit, kur shkeljet në fjalë kanë natyrë ndërkombëtare dhe përfshijnë një grup kriminal të organizuar.⁵ Shkeljet në të cilat referon neni 5 i protokollit, janë kryerja me dashje, tentativa për të kryer ose marrë si bashkëpunëtor, si dhe organizimi, drejtimi, asistenca, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi i realizimit, të këtyre veprimeve: a) prodhimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre; b) trafikimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre; c) falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët e zjarrit.

Protokollin, në përmbushje të qëllimeve të tij, kërkon që shtetet jo vetëm të ndjekin penalisht dhe të bashkëpunojnë me shtetet e tjera në rastet e veprimtarive të sipërcituara, si dhe të kapin, sekuestrojnë, konfiskojnë dhe shkatërrojnë armët e zjarrit, pjesët, komponentët dhe municionet e tyre, por edhe të marrin një sërë masash parandaluese që përfshijnë regjistrimin, etiketimin dhe çaktivizimin e armëve të zjarrit, adaptimin ose ruajtjen e një sistemi efikas të liçencimit ose autorizimit të eksportit dhe importit të tyre, marrjen e masave për tranzitin ndërkombëtar të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, marrjen e masave për sigurimin fizik të tyre, si dhe shkëmbimin në tërësi e informacionit mes shteteve.⁶

Ligji nr.9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë". Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë veprimtarinë e kontrollit shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, për sigurimin e interesave kombëtarë të Republikës së Shqipërisë, mbikëqyrjen e respektimit të angazhimeve të saj në traktatet ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre,

² Pjesë nga Rezoluta që i paraprin Protokollit.

³ Neni 2 i Protokollit.

⁴ Neni 1 i Konventës, në lidhje me nenet 1, 2 dhe 13 të Protokollit.

⁵ Neni 4 i Protokollit.

⁶ Nenet 7-11 të Protokollit.

transferimin e armëve konvencionale, si dhe për zbatimin e masave, që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave nga terroristë dhe grupe të tjera për qëllime të kundërligjshme.⁷

Fusha konkrete e zbatimit të këtij ligji është rregullimi i marrëdhënieve juridike që lindin për shkak të veprimtarive për transferimin ndërkombëtar të mallrave, përfshirë shërbimet e ndërmjetësimit, prodhimit, shkencës, bashkëpunimit teknik, demonstrimet e tyre në ekspozitat e panairët ndërkombëtare për qëllime reklamimi, testimi, marketingu dhe veprime të lidhura me to deri në përdorimin përfundimtar apo përdoruesin e fundit, të kryera në përputhje me procedurat e vendosura për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave⁸.

Ky ligj nuk aplikohet për transferimin e mallrave, që kanë lidhje me veprimtaritë e Forcave të Armatosura ose të strukturave të tjera shtetërore të sigurisë të Republikës së Shqipërisë jashtë territorit të saj, ose me veprimtarinë e forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, të kryera në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mekanizmin e kontrollit shtetëror të lëvizjes së këtyre mallrave, nuk aplikohet për transfertat ndërkombëtare të anestezikëve, të armëve sportive e të gjahut, të enëve për gazin, në eksportimin dhe importimin e armatimit personal të personelit të shërbimit ushtarak dhe të organeve të rendit e të sigurisë së brendshme shtetërore, që janë të pajisura me armë, sipas ligjit dhe as për procedurat e kontrollit shtetëror për transferimet ndërkombëtare të eksportit të mallrave, që kanë si qëllim dhënien e asistencës ushtarake, në përputhje me kushtet e parashikuara në marrëveshjet e traktatet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë bën pjesë, si dhe lëvizjen e mallrave jashtë vendit për dhënien e ndihmës së emergjencës shteteve të huaja, kur kjo vendoset sipas ligjit.⁹

Ligji nr.74/2014, datë 10.7.2014 "Për armët". Ky ligj rregullon kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të armëve sipas kategorive konkrete të përcaktuara në këtë ligj, marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe subjekteve për pajisjen me armë e municione, kur një drejtë e tillë ka lindur për shkak të pronësisë apo të detyrës, marrëdhëniet për lëshimin e licencave dhe autorizimeve nga Policia e Shtetit për çdo subjekt të interesuar për veprimtaritë e lejuara me armë, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj, si dhe veprimtarinë e prodhimit, çaktivizimit dhe riparimit të armëve.

Në fushën e veprimit të këtij ligji nuk përfshihen armatimi, pajisjet dhe municionet dedikuar për nevoja të strukturave të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Informativ të Shtetit ose koleksionistëve apo organizmave me karakter kulturor dhe historik

⁷ Neni 1 i ligjit.

⁸ Neni 3 pika 1 e ligjit.

⁹ Neni 3 pika 2 e ligjit.

në fushën e armëve, sipas përkufizimeve të këtij ligji dhe nuk përfshihen as transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe municioneve, importi, eksporti, tranziti dhe veprimtaritë ndërmjetësuese të tyre, të cilat zhvillohen në bazë të ligjit nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, si dhe municionet dedikuar për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.¹⁰

Ky është ligji më i fundit që ka hyrë në fuqi në vendin tonë që rregullon marrëdhënie në fushën e armëve dhe municionit. Ai ka zëvendësuar ligjin e mëparshëm nr.99/2013 “Për armët”, ndërsa ky i fundit kishte zëvendësuar më parë ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, i cili ishte “vjetëruar” dhe nuk i përgjigjej më zhvillimeve të kohës.

*Dispozitat e Kodit Penal: Neni 278 “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”¹¹, Neni 278/a “Trafikimi i armëve dhe i municionit”.*¹² Në Kodin tonë Penal janë aktualisht këto dy dispozita penale që mbrojnë marrëdhëniet juridike të vendosura me legjislacionin e mësipërm në fushën e prodhimit, mbajtjes, tregtimit, eksportimit, importimit dhe tranzitimit të armëve të zjarrit dhe municioneve të tyre (si dhe të minave, bombave e të tjera të kësaj natyre), duke parashikuar si vepra penale rastet e cënimit të këtyre marrëdhënieve.¹³

Duhet përmendur që vepra e penale e “Trafikimit të armëve dhe të municionit” e parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal bën pjesë në grupin e atyre

¹⁰ Nenet 1 dhe 2 të ligjit.

¹¹ Ky nen aktualisht parashikon:

Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.

¹² Ky nen aktualisht parashikon:

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i armëve dhe municionit luftarak ose i pjesëve përbërëse të tyre, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

¹³ Ligji nr.74/2014 “Për armët” përfshin në fushën e veprimit të tij edhe armët e ftohta, armët e gjuetisë dhe armët sportive, për të cilat Kodi Penal, në nenet 279 dhe 280 të tij, në rastet e cënimit të marrëdhënieve të rregulluara nga ky ligj, parashikon respektivisht veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta” dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, por ato nuk janë objekt i trajtimit në këtë punim.

dispozitave penale që u shtuan në këtë Kod me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, menjëherë pas nënshkrimit nga Shqipëria të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000,¹⁴ qëllimi i miratimit të të cilave ishte harmonizimi i plotë i legjislacionit tonë penal me aktet juridike ndërkombëtare, në funksion të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar në tërësi dhe me fokus të veçantë në bashkëpunimin ndërkombëtar mes shteteve në këtë drejtim. Neni 278/a i Kodit Penal parashikon si vepra penale veprimet e *importimit, eksportimit, tranzitimit dhe tregtimit*, në kundërshtim me ligjin, të armëve dhe municionit luftarak, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër. Kësaj dispozite iu bë vetëm një shtesë në vitin 2013 me ligjin nr.144/2013, duke përfshirë në të, krahas armëve dhe municioneve, edhe pjesët përbërëse të tyre, të cilat nuk ishin parashikuar në fillim.

Nga ana tjetër, vepra penale e *“Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armëve luftarake dhe të municionit”* e parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, ka qenë pjesë e Kodit që me miratimin e tij në vitin 1995, por gjatë kohës ka pësuar ndryshime me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013 dhe së fundmi me ligjin nr.98/2014, datë 31.7.2014. Lidhur me qëllimin e punimit tonë, është e nevojshme të përmenden ndryshimet e ndodhura në këtë dispozitë gjatë kohës, që lidhen me objektin tonë të trajtimit.

Me miratimin e Kodit Penal, neni 278 i tij parashikonte si vepra penale veprimet e *prodhimit* (në paragrafin e parë) dhe *mbajtjes, blerjes ose shitjes* (në paragrafin e dytë) së armëve dhe municionit luftarak, bombave apo minave, si dhe të *mbajtjes* (në paragrafin e tretë) së fishekëve të armëve të lehta luftarake, të gjitha këto kur kryhen pa leje të organeve kompetente shtetërore. Pra, si forma të kryerjes së kësaj vepre penale në lidhje me armët, municionet etj., kjo dispozitë në këtë kohë parashikonte *prodhimin, mbajtjen, blerjen ose shitjen* e tyre. Sipas këtij ndërtimi, kjo dispozitë në këtë periudhë ishte e aftë për të mbuluar rastet e tregtimit dhe shitblerjes së armëve, të municionit luftarak, etj., si dhe për të bërë dallimin dhe diferencimin mes prodhimit apo mbajtjes së thjeshtë me shitblerjen e tyre, pasi kjo e fundit mbart një rrezikshmëri më të madhe se dy të parat dhe nevojitet që ligji penal ta trajtojë në mënyrë të diferencuar nga mbajtja e thjeshtë, në mënyrë të veçantë kur ushtrohet si veprimtari apo profesion e mirëfilltë, siç shpeshherë ka rezultuar nga praktika.

Dispozita në fjalë mund të zbatohet në të gjitha rastet e prodhimit, mbajtjes, shitjes, blerjes apo tregtimit të armëve dhe municioneve, si kur ajo kryhet brenda vendit, ashtu edhe kur shtrihet më gjërë duke përfshirë edhe vende të tjera krahas territorit shqiptar. Megjithatë, mosparashikimi në mënyrë të posaçme në këtë dispozitë i kryerjes në territorin e më shumë së një shteti të

¹⁴ Shqipëria e ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar me dt.12.12.2000 dhe menjëherë, në më pak se një muaj, ka miratuar ndryshimet përkatëse në Kodin e saj Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, ndryshime të cilat u bënë përpara ratifikimit me ligjin nr.8920, datë 11.7.2002 të vetë Konventës.

këtyre veprimeve të paligjshme me armët, municionet luftarake, etj., pra i rasteve kur kjo vepër penale merr karakter ndërkombëtar, të cilat paraqesin rrezikshmëri shumë më të madhe sesa kur ajo kufizohet vetëm brenda vendit, do të përbënte në vijim një mangësi të madhe të saj, çka e dëmtonte efektivitetin e luftës ndaj këtij kriminaliteti në veçanti dhe ndaj atij të organizuar në përgjithësi. Pikërisht, për të luftuar në nivel ndërkombëtar krimin e organizuar, karakteri ndërkombëtar i të cilit tashmë është i njohur, si dhe të gjitha aktivitetet kriminale që lidhen me të, shtetet, në kuadër të OKB, hartuan dhe miratuan posaçërisht Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000 dhe Protokollet e saj shtesë. Konventa që në fillim e deklaronte qartë qëllimin e saj kur parashikon se është që të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.¹⁵

Në këtë rrjedhë, ndryshimet e kryera në Kodin Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 që, siç u përmend më lart, ishin të lidhura me frymën dhe parashikimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, preken edhe nenin 278 të Kodit Penal. Kështu, në të njëjtën kohë me parashikimin për herë të parë në Kodin Penal, në nenin e ri 278/a, të veprës penale të “*Trafikimit të armëve dhe të municionit*”, i cili parashikon si vepra penale *importimin, eksportimin, tranzitimin apo tregtimin* e tyre, kur kjo kryhet në kundërshtim me ligjin, ky ligj ndryshoi edhe nenin 278 të Kodit Penal duke hequr nga paragrafi i dytë i tij *blerjen dhe shitjen* e armëve, municionit luftarak, bombave apo minave, etj., dhe duke lënë aty vetëm *mbajtjen* e tyre si formë të kryerjes së kësaj vepre penale. Nisur nga fakti se këto ndryshime në Kodin Penal u bënë në mënyrë të njëkohshme, mund të arsyetohet se legjislatori me këto ndryshime kishte parasysh se tashmë tregtimi apo shitblerja e paligjshme e armëve, municionit luftarak, etj., pavarësisht se nëse kjo veprimtari do të kishte karakter ndërkombëtar apo jo, pra në të gjitha rastet, do të parashikohej dhe ndëshkohej penalisht sipas nenit 278/a të Kodit Penal dhe jo sipas nenit 278 të tij.

3 A është tregtimi i armëve trafikim?

Pas ndryshimeve të mësipërme të Kodit Penal, për njëfarë kohe gjykatat tona¹⁶ në përgjithësi i interpretuan si më sipër, sipas asaj që u arsyetua më lart se ishte vullneti i legjislatorit, të gjitha rastet e *shitblerjes* apo *tregtimit* të armëve, municioneve, bombave apo minave, pra në kuadrin e veprës penale të “*Trafikimit të armëve dhe të municionit*” sipas nenit 278/a të Kodit Penal.

Por, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues penal nr.3, datë 24.1.2011, në një çështje penale që lidhej me një rast trafikimi lëndësh narkotike dhe në funksion të qëllimit të saj për të unifikuar qëndrimet e

¹⁵ Neni 1 i Konventës.

¹⁶ Sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën lëndore për të gjykuar veprën penale “*Trafikimi i armëve dhe i municionit ose i pjesëve përbërëse të tyre*” të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, e ka Gjykata për Krime të Rënda.

gjykatave lidhur me tentativën në kryerjen e kësaj vepre penale, prekën dhe trajtuan edhe kuptimin e dispozitave të Kodit Penal që parashikonin trafikimet e ndryshme, pikërisht të atyre që ishin futur në Kod me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 në funksion të përmbushjes së angazhimeve që rridhnin nga qenia palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. Konkretisht bëhej fjalë për veprat penale *“Trafikimi i personave”* neni 110/a¹⁷, *“Trafikimi i femrave”* neni 114/b, *“Trafikimi i të miturve”* neni 128/b, *“Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës”* neni 138/a, *“Trafikimi i mjeteve motorike”* neni 141/a, *“Trafikimi i armëve dhe i municioneve”* neni 278/a, *“Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive”* neni 282/a dhe *“Trafikimi i narkotikëve”* neni 283/a, të Kodit Penal. Në këtë vendim Gjykata e Lartë arsyetoi në këtë mënyrë:

[L]igjvënësi, për rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në Kodin tonë Penal termin e përgjithshëm “trafikim” për titullimin e veprës (nenet 110/a, 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a).

Sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, *kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.*¹⁸

Rezultati i këtij arsyetimi do të ishte se tashmë rastet e *shitblerjes* apo *tregtimit* të armëve dhe municioneve nuk duhet të konsideroheshin automatikisht si trafikim i tyre dhe të përfshiheshin në nenin 278/a të Kodit Penal që parashikon veprën penale *“Trafikimit të armëve dhe municionit”*, por kjo do të varej nga vendi i kryerjes së veprës penale dhe më konkretisht nëse ajo është shtrirë në më shumë se një shtet apo është e kufizuar vetëm brenda territorit të vendit, qëndrim ky në harmoni të plotë edhe me qëllimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000 dhe Protokollet e saj shtesë, si dhe me vetë arsyet e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar përcakton se një vepër penale ka një natyrë ndërkombëtare në qoftë se: (a) kryhet në më shumë se një Shtet; (b) kryhet në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose

¹⁷ Me ndryshimet e Kodit Penal ku është prekur kjo dispozitë, të bëra me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, titulli i saj është bërë *“Trafikimi i personave të rritur”*.

¹⁸ Pika 19 e arsyetimit të vendimit.

kontrollit kryhet në një Shtet tjetër; (c) kryhet në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një Shtet; ose (d) kryhet në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.¹⁹ Në këtë kontekst, edhe Gjykata e Lartë orientoi në këtë drejtim se përcaktues për të zgjidhur këto raste është “*parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij*”.

Mbas këtij vendimi, rastet e *tregtimit* të armëve dhe municioneve që u paraqitën për gjykim në gjykatat tona tashmë u trajtuan në varësi vendit të kryerjes dhe të shtrirjes së kësaj veprimtarie. Nëse ajo ishte e kufizuar brenda territorit të vendit ose nëse në gjykim nuk vërtetohej shtrirja e kësaj veprimtarie edhe jashtë territorit të vendit, gjykatat duhet që veprën penale të mos e kualifikonin *trafikim* në kundërshtim me ligjin dhe për qëllime fitimi sipas nenit 278/a të Kodit Penal, por *mbajtje* pa leje të organeve kompetente sipas nenit 278 të Kodit Penal²⁰, e cila në fakt është një dispozitë penale shumë më e lehtë dhe që nuk i përgjigjet shkallës së lartë të rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprimtarie. Në të tilla raste ndëshkimi penal u thjeshtëzua dhe u kufizua vetëm në atë masë të veprimeve të paligjshme që mund të përfshiheshin nga neni 278 i Kodit Penal, pavarësisht se kjo veprimtari ishte shumë më e gjerë në shtrirje, në qëllimet e ndjekura dhe në pasojat që shkaktonte. Siç u tha më lart, tashmë neni 278 i Kodit Penal nuk parashikonte më veprimet e *shitjes* dhe *blerjes* së armëve, municioneve, bombave apo minave dhe për pasojë kjo veprimtari nuk ndëshkohej farë si e tillë, por thjesht si *mbajtje* pa leje e armëve, municioneve, etj.,²¹

Gjykimi i këtyre rasteve konkrete të tregtimit të armëve, municioneve, minave etj. dhe interpretimi në praktikë i dispozitave penale nga gjykatat, zbuloi një handicap jo të vogël të ligjit penal në këtë drejtim, të lejuar pa dashje nga ndryshmet e shumta dhe në ndonjë rast në kushte “urgjence” të legjislacionit, i cili në praktikë çon në uljen e efektivitetit të luftimit të këtij kriminaliteti në rastet kur ai kryhet brenda vendit, si një hallkë që shpesh ndodhet mes trafikimit të paligjshëm nga/për jashtë shtetit të armëve, municioneve, minave, etj. dhe përdorimit të tyre për kryerjen e krimeve të tjera të rënda, siç janë plagosjet, vrasjet, deri edhe aktet terroriste. Kjo tregoi se qëllimi i legjislatorit për forcimin të luftës ndaj këtij kriminaliteti, nëpërmjet ndryshimeve të Kodit Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, në fakt nuk është realizuar plotësisht.

¹⁹ Neni 3 pika 2 e Konventës.

²⁰ Për ilustrim mund të përmendet vendimi penal nr.48, datë 24.5.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili, ndryshe nga kërkesa e prokurorisë, për një rast veprimtarie të mirëfilltë tregtimi armësh, fishekësh, deri edhe mina të telekomanduara, ndryshoi kualifikimin ligjor të veprës penale nga “Trafikim i armëve dhe municioneve” neni 278/a i Kodit Penal, në “Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve” neni 278 i Kodit Penal.

²¹ Madje as dy ndryshimet më të fundit të Kodit Penal, me ligjin nr.144/2013, të cilat hynë në fuqi me datë 4.6.2013 dhe me ligjin nr.98/2014, të cilat hynë në fuqi me datë 3.9.2014, megjithëse prekën edhe nenin 278 të tij, nuk u fokusuan farë në këtë aspekt, por vetëm në drejtim të ashpërsimit të sanksioneve penale që parashikon kjo dispozitë dhe dallimit mes mbajtjes pa leje të armëve në ambiente publike dhe në banesë.

4 Parimi i territorit, i prekjes dhe përdorimit të tij, në dispozitat e Kodit Penal

Parimi i territorit, i prekjes dhe përdorimit të tij, që duhet të drejtojnë kuptimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave penale që parashikojnë trafikimet, në të vërtetë nuk është një nocion i ri pasi, sikurse mund të nxirret nga ndërtimi i dispozitave të tjera të Kodit Penal, ai është marrë parasysh nga ligjvënësi në rastet e dispozitave të tjera penale që ndëshkojnë shkeljen e ligjeve dhe rregullave në lidhje me sendet apo materialet e tjera me qarkullim civil të ndaluar apo të kufizuar, siç janë ato për lëndët narkotike në nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal apo për lëndët helmuese, plasëse, djegëse dhe radioaktive në nenet 281, 282 dhe 282/a të Kodit Penal.

Kështu, për lëndët narkotike, neni 283 i Kodit Penal i titulluar “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” përfshin të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me ligjin me këto lëndë brenda territorit të vendit, përfshirë edhe shitblerjen e tyre. Konkretisht në të parashikohen si vepra penale *shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi*, si dhe *mbajtja* e substancave narkotike dhe psikotrope. Ndërsa në rrafshin shtrirjes ndërkombëtare të veprimtarive të paligjshme në lidhje me këto lëndë, është neni 283/a i Kodit Penal i titulluar “*Trafikimi i narkotikëve*” që parashikon si vepra penale *importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin*, në kundërshtim me ligjin, të substancave narkotike ose psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lëndët helmuese, plasëse, djegëse dhe radioaktive, ku në nenet 281 dhe 282 të Kodit Penal parashikohen veprimet e paligjshme që mund të kryhen me to brenda vendit, ku përfshihen *mbajtja, prodhimi, përdorimi, ruajtja, transportimi dhe shitja* e tyre, ndërsa në nenin 282/a të Kodit Penal përfshihen veprimet në lidhje me këto lëndë kur këto veprime kanë karakter ndërkombëtar, pra kur vepra shtrihet jo vetëm në territorin e vendit tonë por edhe më gjerë, duke parashikuar *importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin*, në kundërshtim me ligjin të tyre, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër.

Siç shihet, struktura e këtyre dispozitave të Kodit Penal është e harmonizuar dhe e ndërtuar në përputhje me parimin e prekjes dhe përdorimit të territorit. Ajo i përgjigjet plotësisht nevojës për të luftuar kriminalitetin që lidhet me të në të gjithë shtrirjen që ai mund të ketë, si brenda vendit, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Njëkohësisht ato mundësojnë një bashkëpunim më të mirë në fushën gjyqësore mes vendit tonë dhe shteteve të tjera, që është edhe qëllimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000 dhe Protokolleve të saj shtesë, si dhe i instrumenteve të tjerë juridike ndërkombëtarë në fushën penale ku vendi ynë është palë.

Ndryshe qëndron çështja me strukturën e dispozitave të Kodit Penal në lidhje me veprimet e paligjshme me armët, municionet, minat, etj. Sikurse u trajtua më lart, ato nuk janë të harmonizuara plotësisht me njëra-tjetrën dhe me dispozitat e tjera që përmbushin të njëjtin qëllim në kuadër të luftimit të njëkohshëm të kriminalitetit dhe të krimit të organizuar në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar, aspekte të cilat nuk mund të jenë dhe as të shihen të shkëputura nga njëra-tjetra. Struktura e këtyre dispozitave nuk mban parasysh plotësisht parimin e territorit, prekjes dhe përdorimit të tij, si dhe sjell uljen e efektivitetit të tyre në luftimin e këtij kriminaliteti brenda vendit, por me pasoja shumë të rrezikshme në rastet kur ushtrohet si biznes i mirëfilltë kriminal.

Nisur nga kjo analizë, arrijmë në përfundimin se shtrohet në mënyrë imediate nevoja e përmirësimit të Kodit Penal për të harmonizuar dispozitat që lidhen me armët, municionet, etj. me njëra-tjetrën dhe më strukturën e përgjithshme të kodit që lidhet me luftimin e njëkohshëm të kriminalitetit të organizuar në rrafshin e brendshëm dhe në shtrirjen e tij ndërkombëtare, përmirësim i cili duhet bëhet në përputhje me parimin i territorit, siç del e nevojshme nga ajo që kanë konstatuar precedentët gjyqësorë.

5 Konkluzione dhe rekomandime

Siç u analizua më lart, mungesa e harmonizimit të dispozitave të Kodit Penal në fushën e tregtimit dhe trafikimit të armëve dhe municioneve luftarake, shkaktuar gjatë ndryshimeve të vazhdueshme të tij, ndikon dukshëm në efektivitetin e politikës penale ndaj këtyre veprimtarive të paligjshme.

Ndryshimet dhe përmirësimet e vazhdueshme të ligjit penal, sidomos në fushën e krimit të organizuar dhe trafikimeve, në tërësi e kanë rritur shkallën e përgjigjes së shtetit dhe shoqërisë ndaj këtij kriminaliteti, si në nivel vendor, ashtu edhe bashkëpunimi me shtetet e tjera, por precedentët gjyqësorë kanë zbuluar se ka ende disa mangësi në Kodin Penal në lidhje me disa shfaqje të veçanta të kësaj veprimtarie në rastet e tregtimit të paligjshëm brenda vendit të armëve dhe municioneve luftarake.

Nisur nga këto rrethana, rezulton dukshëm se nevojiten përmirësimet të mëtejshme të Kodit Penal në këtë drejtim, për t'ju përgjigjur më mirë përhapjes si një veprimtari më vete të tregtimit të paligjshëm brenda vendit të armëve dhe municioneve luftarake, si një veprimtari që shpesh herë merr përmasa shumë të gjera dhe të rrezikshme.

Për këtë arsye, në këtë punim propozohet që të bëhet një strukturim të ndryshëm i dispozitave penale konkrete nëpërmjet ndryshimeve ligjore në Kodin Penal, kjo në bazë dhe në respektim të parimit të territorit, të prekjes dhe përdorimit të tij, duke marrë për model dispozitat për narkotikët apo ato për lëndët plasëse, helmuese dhe radioaktive të parashikuara në po këtë kod, ku të parashikohen në dispozita penale më vete rastet kur veprat penale kryhen apo janë të kufizuara brenda vendit dhe kur ato janë të shtrira edhe në shtete të tjera krahas vendit tonë. Vetëm në këtë mënyrë mund të harmonizohen mbi bazën e

të njëjtit parim të gjitha dispozitat penale që lidhen me goditjen e veprimtarive të paligjshme të kryera me sendet, lëndët apo materialet me qarkullim civil të ndaluar apo të kufizuar, që janë ndër objektet dhe mallrat kryesore që tërheqin interesin e krimit të organizuar.